

VENDIM
Nr. 222, datë 9.11.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË
RINOVUESHME NGA DIELLI, ERA DHE NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E
MBETJEVE TË NGURTA, QË SHFRYTËZOJNË MBETURINAT INDUSTRIALE,
URBANE DHE RURALE, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 139/7 prot., datë 5.11.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2021”,

konstatoi se:

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM për sa i takon LCOE-së dhe WACC-së ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- VKM-ja nr. 27, datë 17.1.2018, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”, përcakton ndër të tjera se për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur. Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM-në e mësipërme, është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së (kosto e niveluar e energjisë elektrike).

- Ndërkohë, metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 27, datë 17.1.2018, përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit që duhet të paguhet për një njësi output si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar, ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mWh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.

- MIE, me anë të shkresës me nr. 7789 prot., datë 29.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1042 prot., datë 2.11.2021, i drejtohet ERE-s për të vijuar procedurat për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi.

- ERE, me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga këto burime, do t'i drejtohet MIE-s për informacion, lidhur me subjektet për të cilat Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka lëshuar: 1. autorizimin paraprak; 2. miratimin përfundimtar, për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, për vitin 2021.

2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti